



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
BASHKIA PËRMET  
KËSHILLI BASHKIAK

### Njoftim për konsultim publik

**Titulli i Projekt-aktit : "PROJEKT DOKUMENTI PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2025 - 2027"**

**Propozuesi :** Projekt –akti është propozuar nga ana e Kryetares së Bashkisë.

Sqarime për projekt-aktin : Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përsë do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndërsa tjetra, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjite lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

**Kalendari i konsultimit :** Konsultimi publik do të realizohet në përputhje me Kalendarin e Konsultimit Publik

**Pjesëmarrës :**

- **Nga ana e Bashkisë :** Kryetarja e Bashkise, kryetarja e Keshillit Bashkiak, Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financës të Këshillit, Kryetari i Komisionit të Sherbimeve te Këshillit, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, këshilltarë, drejtori i Finances se Bashkise drejtues/punonjës të administratës/ drejtues te tjere te programeve buxhetore.
- **Nga komuniteti :** Banorët e Bashkisë sipas te gjitha njesive administrative perfshire grupet vulnerabel, Shoqata e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe Kryetarët e Fshatrave.

|                              |   |
|------------------------------|---|
| Qëllimi i këshillimit publik | Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komuniteti, nepermjet ketij keshillimi publik dhe ne zbatim te nenit 18 dhe nenit 54, shkronja "e" te ligjit 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", si dhe ne zbatim te Rregullores se KB Permet "Per Konsultimin Publik" Kërkon opinionin e qytetarëve dhe grupeve të interesit, |
|------------------------------|---|

|   |   |
|---|---|
|   | <i>perfshire grupet vulnerabel, për draft projektet e PBA 2025-2027 si edhe cilat janë shërbimet qe duhet te primiresohen per plotesimin sa me te mire te mundshem te nevojave të komunitetit.</i>  |
| Përshkrimi i cështjes që trajton projekt-akti | Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përsë do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financier vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike përprioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete përofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve . |
| Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut        | <p>Këshilli i Bashkisë ka marrë projekt-vendimin e propozuar nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe bazuar në Ligjin 139/2015 Neni 18, ka vendosur kalimin e tij në konsultim publik.</p> <p>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me cështjet si vijon</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- A mendoni se prioritetet e investimeve dhe te shërbimeve te parashtruara ne kete draft program buxhetor afatmesem, permbushin pritshmerite tuaja ne lidhje me ato qe ju i mendoni si prioritete?</li> <li>- Nese jo, cilat do te ishin disa nga sugjerimet tuaja te cilat duhet te pasqyrohen ne kete draft program ne menyre qe ky te permiresohet duhe permbushur me mire interesat tuaja?</li> </ul>   |
|   |   |





|   |   |
|---|---|
| Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;  | <ul style="list-style-type: none"><li>Në pamundësi pjesëmarrje në takime, Këshillit mund ti dërgohen rekomandimet me poste ne Adresen: Bashkia Permet, Keshillit Bashkiak, Sheshi "Abdyl Frasherri" ose nepermjet postes elektronike ne adresen e sekretarit te Keshillit Bashkiak : <a href="mailto:keshillibashkiak_permet@gmail.com">keshillibashkiak_permet@gmail.com</a></li></ul> <p>deri me date 27/11/2024</p>  |
| Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me cështjen që konsultohet                                 | <p><a href="https://bashkiapermet.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Shtoja-2-PBA-2025-2027-fazall.pdf">https://bashkiapermet.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Shtoja-2-PBA-2025-2027-fazall.pdf</a></p>  |
| Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit | <p><i>Konsultimi publik do të realizohet sipas Kalendarit të Konsultimeve Publike.</i></p> <p><i>Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon :</i></p> <ol style="list-style-type: none"><li><i>Mbajtja e procesverbalit të cdo takimi publik dhe bërja publike e tyre.</i></li><li><i>Marrja e Rekomandimeve me postë dhe bërja e tyre publike.</i></li><li><i>Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përbledhje të Rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përbledhje.</i></li><li><i>Dërgimi i kësaj Përbledhje Rekomandimesh Kryetares së Bashkisë, Komisionit të Ekonomise dhe Financës.</i></li><li><i>Hartimi i projekt-vendimit të përmirësuar bazuar në rekomandimet e konsultimit publik.</i></li><li><i>Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit.</i></li></ol> |

#### Kryetare e Keshillit

Anila DHIMITRI

